



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:059649

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06355630

C.nr.504/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" me seli në Prishtinë, me objekt të padisë kompensim i dëmit, me vlerë të kontestit 1,000.00 €, jashtë seance së shqyrtimit me datë 25.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia-

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit A.K. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të "OBLIGOHET e paditura që të paguaj vlerën e dëmit të shkaktuar në vlerë prej 1,000.00 euro paditësit me kamatë ligjore prej 8 duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë gjer në pagesën definitive dhe shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit ekzekutues".

II. Shpenzimet procedurale bien në barrë të paditësit.

A r s y e t i m

Paditësi A.K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datë 30.03.2021, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" me seli në Prishtinë, me objekt të padisë kompensim i dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 €.

Paditësi - i autorizuari i tij përfaqësuesi av. D.M. ka dorëzuar parashtresë më 25.10.2024 pranë kësaj gjykate, ku ka deklaruar se pala nuk ka interes për vazhdimin e procedurës pasi që me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore dhe mbi këtë bazë në mungesë të interesit juridik për vazhdim të ndjekjes së çështjes përmes Gjykatës bëjmë heqje dorë nga kërkesëpadia, duke u bazuar në nenin 149 të LPK-së.

Në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata vendosi që të njëjtat të bien në barrë të palës paditëse.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 149.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), pa shqyrtim të mëtejshëm, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.504/2021, 25.10.2024

Gj y q t a r i

Gëzim Shehu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.